



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 451 Prot.

Tiranë, më datë 17.05.2022

VENDIM
Nr. 166, datë 17.05.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.05.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rikonstruksion banese ekzistuese 1 kat+ podrum”, brenda kufirit zonë Arkeologjike “A” Durrës, me aplikues Adlei Likmeta dhe zhvillues Raimond Laçi;
 - Të paraqiten grafikusht të detajuara plani i themeleve, kolonave si dhe infrastruktura hidrike dhe elektrike,
 - Të shpjegohet grafikusht dhe në relacion, si do të realizohet propozimi për çlirimin e bodrumit nga pesha e dherave,
 - Të paraqiten foto cilësore të gjendjes aktuale të godinës dhe bodrumit.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

